



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 827/5 prot.

Tiranë, më 07.05.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj datë 29.04.2024

QENDRA “RES PUBLICA”

Z. D M DREJTOR EKZEKUTIV

Të dhëna kontakti: e-mail: [qendra.respublica@gmail.com](mailto:qendra.respublica@gmail.com)

Adresa: “Blv. Gjergj Fishta”, Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

I nderuar z. M ,

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 29.04.2024, protokolluar me tonën nr. 827/4 prot., datë 30.04.2024, ju informojmë si më poshtë:

Përgjigjet që Komisioni ju ka kthyer për dy kërkesat e para për informacion kanë qenë shteruese, korrekte dhe sipas ligjit.

Sa i takon pyetjeve të renditura nga ana juaj, në kërkesën e datës 29.4.2024, sjellim në vëmendjen tuaj se, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në nenin 1, pika 1 të tij, përcakton se: “1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.” Më tej, neni 2, në pikën 2 të tij, klasifikon si informacion publik “çdo informacion të regjistruar në çfarëdo lloj forme ose formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.

Për sa më sipër, konstatojmë se 5 pyetjet tuaja, kërkojnë koment nga ana jonë dhe jo vënie në dispozicion të informacionit publik në kuptim të ligjit. Për rrjedhojë, vlerësojmë se ato janë jashtë objektit të ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe nuk mund të trajtohen nga ana e Komisionit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHS

Edmond VERCANI

